

Kuvendi nuk arrin t'i votojë dy marrëveshje të rëndësishme ndërkombëtare



KA NDËRRUAR JETË SIMBOLI I REZISTENCËS KOMBËTARE, ADEM DEMAÇI

Prehu në paqe, HERO!

- Presidenti Thaçi ka shpallur tri ditë zie për vdekjen e veprimtarit Adem Demaçi

Simboli i rezistencës kombëtare, Adem Demaçi, ka ndërruar jetë të enjten në moshën 82-vjeçare pas një sëmundje të rëndë nga e cila po vuante. Ai ka qenë i burgosur politik për 28 vjet gjatë jetës së tij. Për vdekjen e bacës Adem kanë shprehur ngushëllime përfaqësues të institucioneve të Kosovës, liderë partish, organizata të dala nga lufta e UÇK-së, përfaqësues të shoqërisë civile dhe qytetarë të shumtë. Varrimi i veprimtarit të çështjes kombëtare, Adem Demaçi, do të bëhet të shtunën me ceremoni shtetërore, kurse nesër (e premte), me fillim nga ora 12:00, do të ketë homazhe në Teatrin Kombëtar të Kosovës



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com

Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

GJENOCIDI I PANDËSHKUAR I SERBISË KUNDËR SHOQIPTARËVE GJATË LUFTËS NË KOSOVË NUK ISHTE AS I PARI AS I RASTIT F. 11



Fetnete RAMOSAJ

HERONJTË SI ENVER ZYMBERI DO TË KUJTOHEN GJITHMONË F. 6

AAK-ja BËHET ME 13 NËNKRYETARË F. 6

EKONOMI

BEQAJ: DIGJITALIZIMI NDIHMON PRODHUESIT VENDORË F. 9

SAMIR MANE: FERRONIKELI, POTENCIAL I MADH I ZHVILLIMIT F. 9

KULTURË

DURIM KRYEZIU, PJESË E 'MATCHMAKING FORUM' NË FESTIVALIN E FILMIT TË PULËS F. 10

SPORT

FFK-ja BËN THIRRJE TË MBUSHET STADIUMI 'FADIL VOKRRI' F. 14

IBRAIMI, BESNIK I SHKËNDIJËS F. 14



PRESIDENTI I KOSOVËS, HASHIM THAÇI, KA PRITUR NË TAKIM PËRFAQËSUESIT E LUGINËS SË PRESHEVËS

Thaçi: S'ka ndarje e as shkëmbim të territoreve

Nuk do të ketë as ndarje të Kosovës dhe as shkëmbim të territoreve. Kështu ka deklaruar presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të enjten në një konferencë të përbashkët për medie pas takimit që ka pasur me

përfaqësuesit politikë të Luginës së Preshevës. Presidenti ka bërë me dije se mbrojtja dhe avancimi i të drejtave të shqiptarëve të Luginës së Preshevës do të jenë pjesë e agjendës së dialogut në mes të

Kosovës dhe Serbisë. Kurse sa i përket kërkesës së liderëve shqiptarë të Luginës së Preshevës për bashkim me Kosovën, Thaçi ka thënë se një gjë të tillë është pothuajse e pamundur

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Rritja e ndikimit të Turqisë në Ballkan

Trashëgimia historike e ka bërë rajonin një përparësi për partinë në pushtet në Turqi, AKP-në, nën drejtimin e presidentit të rizgjedhur Rexhep Tajip Erdogan. Ndikimi në rritje i Turqisë ishte i dukshëm në ceremoninë e inaugurimit të këtij muaji të Erdoganit



PRISHTINË, 26 KORRIK - Turqia po e zgjeron ndikimin ekonomik dhe kulturor në vendet e Ballkanit dhe analistët thonë se strategjia me objektiv vendet me shumicën e banorëve myslimanë po i shqetëson disa nga aleatët perëndimorë.

Rajoni i Ballkanit ka qenë qendër e Perandorisë Otomane. Kjo trashëgimi historike e ka bërë rajonin një përparësi për partinë në pushtet në Turqi, AKP-në, nën drejtimin e presidentit të rizgjedhur Rexhep Tajip Erdogan. Ndikimi në rritje i Turqisë ishte i dukshëm në ceremoninë e inaugurimit të këtij muaji të Erdoganit. Ndërsa udhëheqësit e Evropës Perëndimore nuk ishin të pranishëm, udhëheqës të pesë vendeve të Ballkanit morën pjesë në ceremoni. "Për sa kohë që partia AKP ka në mendje ta rigjallërojë të shkuarën otomane, Ballkani është i rëndësishëm për ta", thotë profesor Istar Gozaydin, studiues për Ballkanin. "Ballkani, si rajon, për shumë shekuj me radhë, ishte nën ndikimin dhe sundimin otoman. Unë shoh një ringjallje të identitetit islamik dhe të ndikimit turk në rajon", thotë profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare Huseyin Bagci, ekspert për Ballkanin në Universitetin Teknik për Lindjen e Mesme në Ankara. "Turqia është duke përdorur pushtetin e vet kulturor, ekonomik dhe gjuhësor të pakicat turke që jetojnë në Ballkan, për ta shtuar influencën në këtë

rajon", shton profesori Bagci. Disa udhëheqës evropianë kanë shprehur shqetësimin e tyre për këtë çështje. "Nuk dua që Ballkani të drejtohet nga Turqia, apo Rusia", deklaroi në muajin maj presidenti francez Emmanuel Macron. Erdogan u përgjigj menjëherë, duke thënë se ky koment ishte "i papërshtatshëm për një burrë shteti".

Ekonomia turke është shumë më e fuqishme sesa e fqinjëve të saj në Ballkan dhe ekonomia është pikërisht arma kryesore e Ankarasë për ndikim. "Turqia po ndërton aeroporte, po investon në disa sektorë si, p. sh., në Bullgari dhe në Rumani, si industria e tekstilëve e shumë të tjera", thotë eksperti për Ballkanin, Bagci. Turqia po investon për ndërtimin e aeroportit të Vlorës dhe ngritjen e të vetmes kompani fluturimi shqiptare. "Ndaj Ballkanit ekziston një politikë ekonomike agresive, e cila nuk mund të konkurrojë me Turqinë. Në Ballkan janë dy vende të mëdha që kanë ndikim. Njëri është Gjermania, tjetri është Turqia", tha tutje Bagci.

Tregtia e ka ndihmuar Ankarën t'i kapërcejë armiqësitë e së kaluarës. "Shumë prej këtyre vendeve nuk kanë qasje të drejtpërdrejtë në tregun e Bashkimit Evropian, prandaj shumë prej tyre i drejtojnë sytë nga Turqia për tregti", thotë analisti Semih Idiz, i portalit "Al Monitor". "Gjatë luftërave të fundit në Ballkan, Turqia dhe Serbia ishin në kahe të ndryshme. Të dyja

vendet kishin armiqësi me njëri-tjetrin. Sot ne shohim që Serbia dhe Turqia kanë marrëdhënie të afërta, me gjithë mosmarrëveshjet lidhur me Kosovën dhe Bosnjën dhe për çështje të tjera të kësaj natyre. Një vend si Serbia e vlerëson miqësinë me Turqinë dhe unë mendoj se kjo është e vlefshme edhe për vende si Kroacia", shton Idiz, duke iu referuar ngjarjeve që sollën shpërbërjen e ish-Jugosllavisë.

Serbia tani është partnerja kryesore tregtare e Turqisë në Ballkan, me një bilanc tregtar prej një miliard dollarësh. Shfrytëzimi i lidhjeve me popullsinë turke që jeton në Ballkan, përmes promovimit të fesë dhe kulturës, është një tjetër mjet jetik që përdoret nga Ankara. "Ata janë duke përdorur fenë dhe diplomacinë. Institucione si Tika dhe Diyanet zhvillojnë punë të madhe në rajon", thotë Gozaydin.

Tika është agjencia shtetërore turke e zhvillimit, ndërsa Diyanet është agjencia që merret me çështjet islamike si brenda dhe jashtë vendit. Të dyja këto institucione janë në ballë të përpjek-

jeve për zgjerimin e ndikimit turk në Ballkan. "Ato punojnë me autoritetet e këtyre vendeve dhe përpiqen të ndikojnë te politika e tyre. Në Bosnjë, për shembull, përpiqen të ndikojnë tek emërimi i autoriteteve fetare, me synimin për të bashkëpunuar me ta", thotë Gozaydin.

Turqia ka financuar projekte për ndërtimin e xhamive në mbarë Ballkanin, përfshirë dy nga xhamitë më të mëdha të rajonit, në Shqipëri dhe në Bullgari. Fondacionet kulturore turke, po ashtu, punojnë për promovimin e identitetit etnik turk. "Por ndërsa Ankara ka qenë e suksesshme për ta shtuar ndikimin e vet, ka shenja të shtimit të shqetësimeve për këtë", paralajmëron Gozaydin. "Kam takuar shumë njerëz në këto vende, si autoritete e të tjerë, të cilët janë të pakënaqur me përpjekjet e mëdha të Turqisë për të pasur ndikim te këto vende. Kjo është konsideruar si ndërhyrje në politikën e brendshme të këtyre vendeve", thotë Gozaydin.

Vitin e kaluar Shtetet e Bashkuara u shprehën të alarmuara për politikat e Ankarasë. "Ballkani është një rajon për të

cilin kemi shqetësime të mëdha", tha këshilltari i asaj kohe për sigurinë kombëtare, gjenerali H. R. McMaster.

Ankaraja i ka hedhur poshtë këto kritika, duke thënë se thjeshtë është duke rivendosur lidhjet kulturore shekullore dhe shton se Rusia dhe vendet evropiane janë duke u përpjekur së tepërmi për të pasur ndikim në Ballkan. Në muajin maj, zyrtarë evropianë zhvilluan bisedime me udhëheqësit e Ballkanit Perëndimor në Bullgari, për ta ritheksuar "perspektivën evropiane" të rajonit. Duke pasur parasysh historinë e viteve të kaluara me konflikte etnike dhe fetare në rajon, analistët paralajmërojnë për rrezikun e reaguesimeve të ashpra nacionaliste, nëse Ankara nuk i mat hapat e saj me kujdes. "Pakicat turke, apo myslimane, konsiderohen si një kërcënim i mundshëm nga shumica e vendeve ballkanike. Sa më tepër forcohet identiteti mysliman, aq më shumë lëvizjet populiste kanë për t'u rritur dhe fuqizuar në Ballkan, sikurse në Gjermani dhe vende të tjera. Ekziston mundësia për konflikte", thotë analisti Bagci.

Mull: Shqipëria, faktor strategjik në rajon

TIRANË, 26 KORRIK - Nënsekretari i Shtetit për Çështjet Politike në Departamentin Amerikan të Shtetit shpreh mirënjohjen dhe vlerësimin e ShBA-së për partneritetin me Shqipërinë, duke theksuar se ShBA-ja është me fat që ka miq të tillë. Lajmi është bërë me dije nga nënsekretari i Shtetit për Çështjet Politike, Stephen Mull, në rrjetin social "Twitter". "Këtë javë pata kënaqësinë ta takoja min-

istrin e Jashtëm të Shqipërisë, Ditmir Bushati, në Uashington, për të diskutuar për kontributin e madh të Shqipërisë në komunitetin Transatlantik. ShBA-ja është me fat që ka miq të tillë", shkruan Mull në rrjetin social "Twitter", pas takimit me ministrin e Jashtëm, Ditmir Bushati. Ky fundit ndodhet në Uashington, ku po merr pjesë në takimin e ministrave mbi "Lirinë getare" me ftesë të

Sekretarit të Shtetit, Mike Pompeo. Mull dhe Bushati zhvilluan një takim më herët, gjatë të cilit zyrtari amerikan theksoi rëndësinë strategjike që ShBA-ja i jep integritet të Shqipërisë në BE dhe vazhdimin e zbatimit të reformave të brendshme. Ai falënderoi Shqipërinë për kontributin e çmuar si në kuadër të NATO-s, ashtu dhe si faktor konstruktiv në rajonin e Ballkanit Perëndimor.



Ka ndërruar jetë simboli i rezistencës kombëtare, Adem Demaçi

Prehu në paqe, HERO!

- Presidenti Thaçi ka shpallur tri ditë zie për vdekjen e veprimtarit Adem Demaçi

Simboli i rezistencës kombëtare, Adem Demaçi, ka ndërruar jetë të enjten në moshën 82-vjeçare pas një sëmundje të rëndë nga e cila po vuante. Ai ka qenë i burgosur politik për 28 vjet gjatë jetës së tij. Për vdekjen e bacës Adem kanë shprehur ngushëllime përfaqësues të institucioneve të Kosovës, liderë partish, organizata të dala nga lufta e UÇK-së, përfaqësues të shoqërisë civile dhe qytetarë të shumtë. Varrimi i veprimtarit të çështjes kombëtare, Adem Demaçi, do të bëhet të shtunën me ceremoni shtetërore, kurse nesër (e premte), me fillim nga ora 12:00, do të ketë homazhe në Teatrin Kombëtar të Kosovës

**EPOKA
ERE****Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 26 KORRIK - Të enjten është ndarë nga jeta, në moshën 82-vjeçare, veprimtari i shquar i çështjes kombëtare, Adem Demaçi. I dhënë pas veprave të autorëve shqiptarë, ai kishte studiuar letërsi, por edhe drejtësi dhe pedagogji në Beograd, Prishtinë dhe Shkup. Me prejardhje nga fshati Lupq i Podujevës, Adem Demaçi lindi më 26 shkurt 1936 në Prishtinë. Adem Demaçi ishte veprimtar për kauzën kombëtare në kohën e Jugosllavisë dhe luftonte për barazinë e Kosovës me republikat e tjera të Jugosllavisë. Për angazhimin e tij politik, Adem Demaçi vuajti 28 vjet me radhë në burgjet e Jugosllavisë. Pasi u lirua, menjëherë vazhdoi aktivitetin politik.

Adem Demaçi udhëhoqi Këshillin për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut (KMDLNj) nga viti 1990 deri më 1995. Në vitin 1991 u nderua nga Parlamenti Evropian me Çmimin Saharov. Gjatë periudhës 1998/1999, kur mbaheshin takimet në Rambuje për të ardhmen e Kosovës, ai ishte zëdhënës politik i UÇK-së. Ishte kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës (2005-2007). Sot njerëzit e rezistencës kombëtare identifikohen me emrin e Adem Demaçit, sepse ai me punën e vet dhe me veprën e tij u bë simbol i unifikimit për ruajtjen e kombin shqiptar, mbi pesë dekada. Adem Demaçi me jetën dhe veprën e vet është një personalitet i përmasave të historisë së përgjithshme njerëzore, ku bën pjesë edhe historia jonë kombëtare. Ka botuar romanin "Gjarpinjtë e gjakut" në fillim të viteve '50, por është ndaluar nga

regjimi ish-komunist deri në fillim të viteve nëntëdhjeta, kur nisi të qarkullojë lirshëm.

Thaçi: Adem Demaçi tërë jetën ia kushtoi Kosovës

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se e ka të vështirë ta pranojë se veprimtari i çështjes kombëtare, Adem Demaçi, ka ndërruar jetë. Ai ka pohuar se baca Adem tërë jetën ia ka kushtuar Kosovës. "Është shumë e vështirë ta pranojmë që simboli ynë i rezistencës, baca Adem, ka ndërruar jetë. Ishte gjithmonë i pathyeshëm dhe i papërkulur përballë çdo sfide. Baca Adem tërë jetën ia kushtoi Kosovës dhe ne gjithmonë do ta kujtojmë si udhërrëfyes dhe do ta kemi si zë ndërgjegjeje popullorë. I lehtë i qoftë dheu i Kosovës!", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Veseli: Lamtumirë hero i Kosovës

Kurse kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se mbarë kombi shqiptar është i tronditur nga humbja e veprimtarit të çështjes kombëtare, Adem Demaçi. Ai ka thënë se Demaçi do të jetë në mesin tonë derisa të ekzistojë populli shqiptar. "Më 17 shkurt të këtij viti isha për vizitë te Baca Adem për t'ia uruar përvjetorin e 10 të pavarësisë. Ndonëse i sëmurë, në asnjë çast nuk tregoi shenja dobësimi. I fortë dhe plot vullnet si gjithmonë. E patëm lënë të takoheshim sërish, por këtë herë në Kuvendin e Kosovës. Fati nuk e deshë që ai të vinte. Por, Adem Demaçi do të rrojë me ne derisa të ekzistojë ky popull, për lirinë e të



cilit ai barti mbi supet vuajtjet dhe përpjekjet më të mëdha. Jo vetëm Kosova, por mbarë kombi shqiptar është i tronditur sot nga humbja e një ndër bijve më të shquar. Me kurajën, sakrificën dhe atdhedashurinë e tij të jashtëzakonshme ai u bë simbol i rezistencës dhe përpjekjeve të shqiptarëve për liri e barazi në trojet e veta. Vepra e tij shërbeu si burim frymëzimi jo vetëm për luftën tonë të armatosur, por edhe për ndërtimin e shtetit të ri të Kosovës, në bazë të themeleve të shëndosha, të vlerave të lirisë e demokracisë. Lamtumirë Adem Demaçi, hero i Kosovës, frymëzimi dhe krenaria jonë! Ngushëllime, Kosovë!", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Haradinaj: Prehu në paqe Baca Adem!

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se atdheu do ta nderojë dhe kujtojë veprën e Adem Demaçit, i cili ka ndërruar jetë të enjten pasdite. "Prehu në paqe, Baca Adem! Gjithë jetën i shërbeve dhe gjithë jetën e nderove atdheun. Përjetësisht atdheu do ta nderojë e kujtojë veprën dhe emrin tënd", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Limaj e quan të trishtë lajmin për vdekjen e Bacës Adem, thotë se gjithë jetën ia kushtoi vendit

Kryetari i Nismës Socialdemokrate dhe zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, ka shprehur ngushëllimet e tij për familjen Demaçi, për vdekjen e veprimtarit të shquar shqiptar. Baca Adem, siç

shkruan Limaj në telegramin ngushëllues, ishte dhe mbetet frymëzuesi më i mirë për djemtë dhe vajzat e reja që duan ta nderojnë vendin dhe kombin e vet. "I trishtë lajmi për vdekjen e sakrificës dhe rezistencës kombëtare Adem Demaci, që ne me dashuri dhe respekt e thërrisim Baca Adem. Do ta kujtojmë gjithmonë rezistencën dhe sakrificën tënde. Baca Adem kishte një jetë plot sfida e sakrifica për kombin shqiptar. Ngushëllime familjes, bashkëveprimtarëve dhe gjithë kombit!", thuhet, ndër të tjera, në ngushëllimin e Limajt.

OVLUÇK-ja: Adem Demaçi ishte i mbarë kombit shqiptar

Kryesia e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së ka shprehur ngushëllimet më të thella me rastin e ndarjes nga jeta të veprimtarit të madh të çështjes kombëtare dhe bashkëluftëtarit të tyre Adem Demaçi. "E nderuar familje Demaçi, mbahuni e qëndroni e fortë në këto çaste dhimbjeje. Ai nuk ishte vetëm i juaji, por i mbarë kombit shqiptar, sepse dihen kontributet e mëdha të tij që dha për çështjen kombëtare", është

thënë në telegramin ngushëllues të kryesisë së OVLUÇK-së.

Haliti: Baca Adem do të na mungojë të gjithëve

Nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, Xhavit Haliti, ka thënë se e ka goditur rëndë lajmi për vdekjen e veprimtarit të çështjes kombëtare, Adem Demaçi. Ai ka thënë se e kishte idol bacën Adem Demaçi. "Lajmi për vdekjen e simbolit të rezistencës dhe çlirimit të Kosovës, frymëzuesit të gjeneratave të tëra për liri, të drejta njerëzore dhe kombëtare, më goditi rëndë.

Adem Demaçin e kisha idol gjatë gjithë jetës. Dhe, pata fatin e madh, që gjatë bashkëpunimit me të, të mësoj se si duhen Atdheu e Kombi. Ikonat si Demaçi rrallë lindin. Baca Adem do t'i mungojë jo vetëm familjes, por të gjithëve. Do t'i mungojë Kosovës dhe gjithë Kombit. Ngushëllime familjes, bashkëveprimtarëve dhe gjithë Kombit! Prehu në paqe, Baca im i shtrenjtë!", ka shkruar Haliti në llogarinë e vet në "Facebook".

LDK-ja: Adem Demaçi ishte simbol i rezistencës

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) i ka shprehur ngushëllimet më të sinqerta familjes Demaçi dhe të gjithë qytetarëve të Kosovës për ndarjen nga jeta të veprimtarit të shquar kombëtar, Adem Demaçit. "Adem Demaçi ishte simbol i rezistencës kundër regjimit të Serbisë në Kosovë, duke mos u nënshtruar asnjëherë para dënimeve drastike dhe dhunës së regjimit serb. Qytetarët dhe populli i Kosovës do ta përkujtojnë përherë veprën kombëtare të Adem Demaçit dhe veprimtarinë e tij në shërbim të lirisë dhe pavarësisë së Kosovës", është thënë në telegramin e ngushëllimit të LDK-së.

Presidenti Thaçi ka shpallur tri ditë zie për vdekjen e veprimtarit Adem Demaçi

Në nderim të figurës së veprimtarit të shquar, Adem Demaçi, i cili ka ndërruar jetë të enjten, presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, bazuar në kompetencat kushtetuese dhe ligjore, i ka shpallur tri ditë zie në Kosovë, përkatësisht ditën e premte, të shtunë dhe të diel. Gjatë këtyre ditëve të zisë flamuri shtetëror i Republikës së Kosovës do të ulet në gjysmëshitëzë në të gjitha institucionet shtetërore brenda dhe jashtë vendit.

Vetëvendosje: Adem Demaçi vdiq, por ai është i pavdekshëm

Lëvizja Vetëvendosje ka shprehur ngushëllime për vdekjen e veprimtarit të çështjes kombëtare Adem Demaçit. Në telegramin ngushëllues të kësaj lëvizje thuhet se vdekja e Adem

Demaçit ka pikëlluar rëndë gjithë shqiptarët, në fakt gjithë lirinë dhe shpirtin. "Në këto momente dëshirojmë t'i gjendemi pranë, sidomos familjarëve e të afërme të familjes Demaçi.

Veprimtari i cili kurrë nuk u dorëzua e nuk u thyje, as prej dekadave të burgut, sot nuk është më mes nesh. Adem Demaçi vdiq, por ai është i pavdekshëm. Vigan në pan-

teonin e kombit, me shpirtin e tij të fortë, me parimet e tij të panegociueshme, me vlerat e tij njerëzore e universale, ai e mposhti çdo gjakatar e çdo tiran. Qëndresa e tij do të mbetet

frymëzim, vepra e tij do të jetë mësimi ynë. Je i përjetshëm në zemrat e shqiptarëve, baca Adem!", është thënë në telegramin ngushëllues të Lëvizjes Vetëvendosje.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur në takim përfaqësuesit e Luginës së Preshevës

Thaçi: S'ka ndarje dhe

Nuk do të ketë as ndarje të Kosovës dhe as shkëmbim të territoreve. Kështu ka deklaruar presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të enjten në një konferencë të përbashkët për medie pas takimit që ka pasur me përfaqësuesit politikë të Luginës së Preshevës. Presidenti ka bërë me dije se mbrojtja dhe avancimi i të drejtave të shqiptarëve të Luginës së Preshevës do të jenë pjesë e agjendës së dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Kurse sa i përket kërkesës së liderëve shqiptarë të Luginës së Preshevës për bashkim me Kosovën, Thaçi ka thënë se një gjë të tillë është pothuajse e pamundur

**EPOKA E RE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 26 KORRIK - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të enjten ka bërë me dije se në kuadër të dialogut me Serbinë nuk mund të diskutohet për shkëmbim të territoreve dhe për ndarje. Ai i ka quajtur të pavërteta idetë dhe shkrimet që po plasohen në media për ndarje të Kosovës. "Ndarje nuk do të ketë. Shkrimet për ndarje e shkëmbim territorësh janë të pavërteta. Marrëveshja historike përfundimtare Kosovë - Serbi do të jetë në mes dy vendeve të pavarura", ka deklaruar Thaçi, në një konferencë të përbashkët për medie pas takimit që ka pasur me përfaqësuesit politikë të Luginës së Preshevës. Presidenti Thaçi sërish ka thënë se vazhdimi i dialogut do të jetë i vështirë, duke shprehur skepticizëm për arritjen e marrëveshjes përfundimtare. "Edhe Beogradi edhe Prishtina e dinë shumë qartë se arritja e marrëveshjes përfundimtare do të jetë me gjasa të pakta apo teorike. Unë pres, e kam theksuar edhe më herët, javët,

muajt e ardhshëm se do të ketë zhvillime edhe me të rënda Kosovë - Serbi në kuptimin e dialogut. Dhe është një shans minimale, shumë e vogël e arritjes së marrëveshjes. Unë uroj dhe do të punoj që të ndodhë mrekullia e marrëveshjes, natyrisht në këtë drejtim në një koordinim të plotë me Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës", është shprehur Thaçi. Sido që të jetë presidenti u ka premtuar liderëve politikë shqiptarë të Luginës së Preshevës se mbrojtja dhe avancimi i të drejtave të shqiptarëve të Luginës do të jetë pjesë e agjendës së procesit të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Përderisa presidenti i Serbisë ka të drejtë për t'u interesuar për të drejtat legjitime të serbëve në Kosovë, edhe presidenti i Kosovës ka të drejtë të interesohet për të drejtat legjitime të shqiptarëve në Serbi. Prandaj nuk paraqet ndonjë mëkat apo ndonjë tronditje globale nëse diskutojmë për afirmimin dhe avancimin e të drejtave të shqiptarëve të Luginës së Preshevës. Askush nuk mund të ma mohojë

interesimin tim për shqiptarët në Luginë. Nuk ka asnjë fshehtësi dhe nuk ka asgjë të pazakontë dhe askush nuk duhet të frikësohet nga interesi legjitim i institucioneve të Republikës së Kosovës për të diskutuar dhe adresuar zgjedhjen e problemit të shqiptarëve të Luginës së Preshevës në mënyrë formale me autoritetet e Serbisë. Kosova respekton tërësinë territoriale të shteteve fqinjë, në këtë rast edhe atë të Serbisë, por nuk mund t'i mbyllë sytë përgjithmonë ndaj padrejtësive dhe përbuzjes që u bëhet shqiptarëve të Luginës së Preshevës. Serbia e ka për obligim t'i respektojë dhe t'i afirmojë të drejtat e minoriteteve në përpunje me standardet evropiane", ka theksuar Thaçi, duke shtuar se Serbia është larg përmblidhjes së këtyre standardeve. "Në të ardhmen pres një koordinim më të madh të përbashkët, duke përfshirë këtu edhe bashkësinë ndërkombëtare, konkretisht BE-në, që t'i adresojmë shqetësimet dhe kërkesat legjitime të shqiptarëve të Luginës së Preshevës. Bashkësia ndërkombëtare respektivisht BE-ja nuk mund të

aplikojë standarde të dyfishta apo të ndryshme kur është në pyetje mbrojtja dhe avancimi i të drejtave të komuniteteve në Kosovë apo Serbi", ka thënë ai. Sipas Thaçit, takimi i tij me përfaqësuesit e Luginës së Preshevës si dhe përfshirja e të drejtave të shqiptarëve në procesin e dialogut me Serbinë mund të ngjallë reagime të ashpër të palës serbe. "Natyrisht se unë pres reagim kokëfortë, të ashpër, ndoshta edhe me mesazhe kërcënuese për qytetarët atje dhe liderët në Preshevë, por është e drejta ime t'i takoj liderët shqiptarë të Luginës së Preshevës dhe t'i mbroj të drejtat e tyre. Si president i Kosovës, por në përgjithësi të gjitha institucionet e Kosovës e kemi obligim që jo vetëm t'i dëgjojmë problemet e shqiptarëve të Luginës, por edhe të ndërmarrim veprime konkrete për adresimin e këtyre problemeve në mënyrë demokratike, paqësore dhe në përpunje me standardet evropiane", ka theksuar presidenti. Kurse sa i përket kërkesës së liderëve shqiptarë të Luginës së Preshevës për bashkim me Kosovën, Thaçi ka thënë se një

gjë të tillë është pothuajse e pamundur. "Kam premtuar se do të vazhdojmë të takohemi do t'i analizojmë me seriozitetin më të madh shqetësimet e tyre dhe në kuadër të vazhdimit të dialogut Kosovë - Serbi dhe në kuadër të korrigjimit të kufirit apo procesit të demarkacionit në mes të Kosovës dhe Serbisë ta prezantoj edhe kërkesën e institucionalizuar tanimë të liderëve të Luginës së Preshevës. Sa do të mund të realizohet objektivi dhe e drejta e aspiratave të shqiptarëve të Luginës së Preshevës do të jetë shumë e vështirë, pothuajse e pamundur, por se a do ta prezantoj në tavolinë kur të ulemi si liderë të dy shteteve, do të informoheni shumë shpejt, me gjasë kjo edhe do të ndodhë", është shprehur presidenti Thaçi.

Liderët politikë të Luginës së Preshevës kërkojnë bashkimin me Kosovën

Ndërsa përfaqësuesit politikë të Luginës së Preshevës, përveç mbrojtjes dhe avancimit të të drejtave të shqiptarëve të

shkëmbim terriioresh



Luginës, kanë kërkuar edhe bashkimin me Kosovën në kuadër të fazës finale të dialogut me Serbinë. Ish-kryetari i Komunës së Preshevës, Ragmi Mustafa, ka thënë se Kosova më shumë se kurdoherë më parë duhet t'i marrë përsipër përgjegjësitë që i takojnë për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të shqiptarëve të Luginës së Preshevës. "Në këtë vigjilje të përmbylljes së bisedimeve Prishtinë - Beograd pse të mos zgjidhet edhe problemi i njohur ndërkombëtarisht i Luginës së Preshevës. Në këtë drejtim jemi zotuar ta respektojmë vullnetin politik të shqiptarëve të Luginës të shprehur në referendumin e 1 dhe 2 marsit të vitit 1992, përmes të cilit shqiptarët kanë deklaruar se jemi për një autonomi politike-territoriale me të drejtë bashkëngjitje Kosovës. Kërkojmë të respektohet referendumi i vitit 1992, ku shqiptarët e Luginës do të ishin pjesë e pandashme e Kosovës", ka deklaruar ai. Edhe kryetari i Komunës së Bujanocit, Shaip Kamberi, ka thënë se Republika e Kosovës duhet ta marrë rolin e përkujdesjes për të drejtat e shqiptarëve të

Luginës. "Edhe sot shqiptarët përballen me cenimin e të drejtave themelore. Në këtë fazë, kur tentohet të përmbyllet dialogu me Serbinë, por edhe të gjendet një zgjidhje e një stabiliteti afatgjatë në Ballkanin Perëndimor, Lugina e Preshevës nuk mund të mbetet anash. Sepse nuk mund të ketë stabilitet afatgjatë në Ballkanin Perëndimor derisa ekzistojnë burime që gjenerojnë kriza", ka deklaruar Kamberi. Ndërsa kryetari i Komunës së Preshevës, Shqipërim Arifi, ka thënë se tani shteti i Kosovës duhet ta trajtojë me prioritet çështjen e zgjidhjes së problemeve të shqiptarëve në Luginën e Preshevës. "Jemi të bashkuar për t'i mbrojtur të drejtat tona. Aspirata e shqiptarëve të Luginës së Preshevës duhet të realizohet. Me rëndësi është që ne kemi një dokument demokratik i cili na mundëson përmbushjen e kërkesave tona. Kjo është një e mirë edhe për presidentin i cili tani ka një platformë demokratike, të cilën mund ta përdorë për realizimin e interesave të shqiptarëve të Luginës", është shprehur Arifi.

Lëvizjes Vetëvendosje me konkluzione për të drejtat e shqiptarëve në Luginë

PRISHTINË, 26 KORRIK (ER) - Grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka organizuar të enjten në Kuvendin e Republikës së Kosovës një tryezë për të drejtat e shqiptarëve që jetojnë në komunën e Preshevës, të Medvegjës dhe të Bujanocit. Në këtë tryezë morën pjesë dhe diskutuan hapur përfaqësuesit kryesorë politikë nga këto tri komuna, deputeti shqiptar në Parlamentin e Serbisë, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile, profesorë e veteranë të luftës së UÇPMB-së dhe Avokati i Popullit, Hilmi Jashari. Tryeza u drejtua nga deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Liburn Aliu, i cili nënvizoi faktin se, pavarësisht prej gjendjes së rëndë, shtypjes politike dhe diskriminimit të shqiptarëve nën Serbi, kërkesat e shqiptarëve që jetojnë aty nuk janë marrë parasysh nga pushtetarët në Kosovë. Më tej, një fjalë hapëse në këtë tryezë e mbajti edhe kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, i cili ka theksuar se përfaqësuesit e Kosovës nuk e kanë ngritur asnjëherë çështjen e të drejtave të shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc në dialogun me Serbinë.

Ndërsa ai deklaroi se dashuria në qeverisje nuk është kategori metafizike, ajo matet me buxhet. "Prandaj dhe pushtetarët në Kosovë nuk mund të flasin për dashuri, siç kanë bërë deri më sot, për shqiptarët që jetojnë nën Serbi, pa e shoqëruar retorikën e tyre me buxhet dhe masa konkrete në këtë drejtim", është shprehur Kurti. Ndër të tjera, ai tha se në lidhje me dialogun motivi i Serbisë është që të jetë sa më afër anëtarësimit në BE, kurse i pushtetarëve të Kosovës është të jenë sa më larg Gjykatës Speciale. Nga diskutimet e shumta të pjesëmarrësve në këtë tryezë u nxorën konkluzionet në vijim: Kosova dhe Shqipëria u kanë borxh shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc, e duhet të angazhohen maksimalisht për të drejtat e tyre. Shqiptarët në këto tri komuna kanë dhënë shumë për pavarësinë e dy shteteve shqiptare dhe kanë mbetur padrejhtësisht nën regjimin e Serbisë; marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të ndërtohen mbi baza reciprociteti; te ndalet menjëherë çregjistrimi i vendbanimit dhe shtetësisë që autoritetet e Serbisë po i bëjnë mijëra shqiptarëve nga Presheva, Medvegja dhe

Bujanoci, si dhe të bëhet regjistrimi i tyre edhe nga shteti i Kosovës, në mënyrë që ata mos të trajtohen formalisht në Kosovë si banorë ilegalë; strategjia e ndjekur pas lufte në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc ka rezultuar e pamjaftueshme për të çuar përpara të drejtat e shqiptarëve; Qeveria e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë duhet të hartojnë një strategji të qartë për rrugën para drejt mbrojtjes dhe avancimi i të drejtave të shqiptarëve në këto tri komuna; në Kuvendin e Kosovës duhet të mbahet një debat i veçantë ose seancë e jashtëzakonshme për çështjen e të drejtave të shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc, e cila do t'i trajtonte rezolutat e mëhershme dhe të dilte në vendime për mekanizma konkretë për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve në këto tri komuna; ajo që po quhet pajtim historik në mes të shqiptarëve dhe serbëve nuk mund të realizohet duke harruar e duke mos përfshirë shqiptarët që jetojnë në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc; një prej kushteve në çfarëdo lloj dialogu të ardhshëm Kosovë - Serbi duhet të jetë hapja e çështjes së të drejtave të shqiptarëve në këto tri komuna.



AAK-ja bëhet me 13 nënkryetarë

PRISHTINË, 26 KORRIK (ER) - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka zgjedhur kryesinë e re e cila, sipas statutit, do të jetë për katër vjet. Kryesia e re e AAK-së tashme, sipas një liste të re, përbëhet nga 13 nënkryetarë dhe 3 sekretarë.

Ardian Gjini, Ahmet Isufi, Pal Lekaj, Gazmend Abrashi, Blerim Kuçi, Ali Berisha, Teuta Haxhiu, Muharrem Nitja, Smajl Latifi, Magbule Shkodra, Time Kadriaj, Diellza Hoti dhe Rustem Berisha janë zgjedhur nënkryetarë të

AAK-së.

Kurse Besnik Tahiri është zgjedhur sekretar i përgjithshëm i AAK-së, Donika Kadaj është zgjedhur në postin e sekretares organizative dhe Lulzim Peci në postin e sekretarit ekzekutiv.



Kosova dhe Shqipëria nënshkruajnë marrëveshje në fushën e forenzikës

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 26 KORRIK - Ministria e Punëve të Brendshme dhe Agjencia e Kosovës për Forenzikë e Republikës së Kosovës kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Drejtorinë e Policisë së Shtetit, përkatësisht Institutin e Policisë Shkencore të Republikës së Shqipërisë.

Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, ka thënë se shkëmbimi i përvojave dhe bashkëpunimi në mes të AKF-së dhe IPSH-së është tejet i rëndësishëm për luftimin, parandalimin dhe zbulimin e ngjarjeve

kriminale dhe zbatimin me rigorozitet të legjislacionit në të dy vendet. "Përvoja e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë ka bërë që ky institucion të jetë i besueshëm gjatë gjithë këtyre viteve. Ky bashkëpunim në mes të AKF-së dhe IPSH-së do ta ndihmojë zhvillimin dhe zgjerimin e kapaciteteve forenzike në të ardhmen", ka thënë Gashi.

Ndërsa ministri i Punëve të Brendshme të Shqipërisë, Fatmir Xhafaj, u shpreh se kjo marrëveshje është shumë e rëndësishme për thellimin e bashkëpunimit në fushën e policisë shkencore, shfrytëzimin e kapaciteteve të laboratorëve të kriminalistikës, shkëmbimin e ekspertëve dhe ekspertizës.



Qëllimi i kësaj marrëveshje të bashkëpunimit është ta bëjë

shtimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dhe forcimin e

bashkëpunimit midis institucioneve të zbatimit të ligjit të dy vendeve nëpërmjet planifikimit dhe zbatimit të masave të përbashkët, si dhe vendosjen e bashkëpunimit konkret në fushën e parandalimit dhe zbulimit të ngjarjeve kriminale dhe zbatimin me rigorozitet të legjislacionit për krijimin e një ambienti më të sigurt për të gjithë qytetarët. Gjithashtu, memorandumi i bashkëpunimit ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit ndërmjet AKF-së dhe IPSH-së për rritjen dhe forcimin e kapaciteteve dhe profesionalizmit në zbatimin e shkencave ligjore si dhe për shkëmbimin e informacioneve dhe përvojave më të mira.

Ministri Berisha dhe gjeneral Rama nderojnë kolonel Ahmet Lekën



PRISHTINË, 26 KORRIK (ER) - Ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës (MFSK), Rustem Berisha, dhe komandanti i FSK-së, gjeneralëjtënant Rrahman Rama, kanë pritur në takime të ndara atasheun ushtarak shqiptar, kolonel Ahmet Leka, me rastin e përfundimit të misionit të tij. Ministri Berisha dhe komandanti Rama falënderuan kolonelin Leka dhe përmes tij Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë për kontributin e tyre të madh në avancimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në shumë fusha. Në shenjë falënderimi, ministri Berisha kolonelit Leka i dhuroi mirënjohje për angazhimin e tij në avancimin e bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës. Atasheu Ushtarak i Republikës së Shqipërisë,

kolonel Ahmet Leka, është shprehur falënderues për bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve gjatë ushtrimit të mandatit të tij në Kosovë. "Kam pasur fat dhe privilegj të punoj me ju ministër Berisha. Jam ndier shumë i vlerësuar dhe i motivuar në detyrën time. Pa dyshim kjo është periudha më e mirë e karrierës sime, pasi më mundësoj të kontribuoj për ju, për vëllezërit e mi, duke realizuar kështu një ëndërr fëmijërie. Duke njohur angazhimin tuaj, potencialet dhe përpjekjet e vazhdueshme për ngritjen e vlerave të ushtarakëve të Kosovës, jam i bindur se janë garancia më e mirë për krijimin e Forcave të Armatosura të Kosovës, përkatësisht transformimin e FSK-së në FAK", është shprehur kolonel Leka.

Për 24 orë policia shqipton 1 743 tiketa trafiku

PRISHTINË, 26 KORRIK (ER) - Policia e Kosovës vetëm gjatë 24 orëve të fundit i ka gjobitur 1 743 persona në trafik. Kjo shifër e shënuar është rekorde të pak-tën deri tani për këtë vit. Së fundi, duke iu referuar statis-

tikave të aksidenteve të shumta në trafik, policia ka formuar "Task Forcë" për t'i parandaluar ato. Për dallim nga aksidentet fatale që nuk u regjistrua asnjë gjatë 24 orëve të fundit, ato me persona të lënduar dhe me

dëme materiale sërish ishin të shumta. Sipas të dhënave të policisë, dje në territorin e Kosovës janë regjistruar gjithsejtë 80 aksidente, prej të cilëve 26 me persona të lënduar dhe 54 të tjerë me dëme materiale.



Heronjtë si Enver Zymberi do të kujtohen gjithmonë

EPOKA
ERE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 26 KORRIK - Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës dhe liderë partish kanë kujtuar të enjten policin Enver Zymberi me rastin e shtatëvjetorit të rënies së tij në mbrojtje të integritetit dhe sovranitetit të Republikës së Kosovës. Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se përkushtimi i Enver Zymberit për mbrojtjen e rendit dhe ligjit, si dhe sakrificat e tij për mbrojtjen e kufijve të Republikës së Kosovës, do të kujtohen përherë me nderimet më të larta institucionale. "Sot e kujtojmë heroin e Kosovës së lirë, Enver Zymberin, i cili ra heroikisht duke mbrojtur integritetin dhe sovranitetin e vendit tonë. Në korrikun e vitit 2011 i kemi dhënë fund idesë së Serbisë për ndarjen e Kosovës. Përkushtimi i Enver Zymberit për mbrojtjen e rendit dhe ligjit, si dhe sakrificat e tij për mbrojtjen e kufijve të Republikës së Kosovës, do të kujtohen përherë me nderimet më të larta institucionale", ka shkruar Thaçi, i cili ka bërë homazhe te lapidari i heroit Enver Zymberi. Edhe kryetari i Kuvendit të

Kosovës, Kadri Veseli, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka thënë se Enver Zymberi do të kujtohet përherë si një hero që dëshmoi dashurinë për atdheun. "Enver Zymberi, në korrik të vitit 2011, ra në mbrojtje të sovranitetit dhe rendit kushtetues të Republikës së Kosovës. Ai do të kujtohet gjithmonë me krenari si një hero që dëshmoi dashurinë për atdheun dhe që me guxim u flijua për ruajtjen e territorit të shtetit tonë. Kosova do t'i nderojë përherë të gjithë heronjtë dhe dëshmorët e saj, duke respektuar amanetin e tyre për një shtet sovran", ka shkruar Veseli. Ndërkaq kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, i shoqëruar nga zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Abduselami Shkodra, ka bërë homazhe te lapidari i heroit të Kosovës, Enver Zymberi, në përvjetorin e shtatë të rënies së tij. Para menaxhmentit të lartë të Policisë së Kosovës, kryeministri Haradinaj nderoi veprën heroike të Enver Zymberit. "Lavdi për Enverin, lavdi për veprën dhe sakrificën e tij", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se Enver Zymberi ra duke e mbrojtur Kosovën e pavarur. Edhe kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka



përkujtuar heroin e Kosovës, Enver Zymberi, për të cilin ka thënë se është hero i integritetit të Kosovës. "Gjatë bombardimeve të NATO-s, kur ishte shumë i ri, Enveri e kishte babanë në burg të Serbisë, kurse me gjithë familjen e deportuan në Shqipëri. Mirëpo, ai menjëherë u mobilizua në radhët e UÇK-së në Kukës dhe hyri në

luftë në Koshare. 12 vjet më vonë bie dëshmor në Kosovën e shpallur të pavarur. Janë të njëjtit pushtetarë që sot nuk kanë vija të kuqe për Serbinë dhe nuk skuqen për zhvatjet e tyre në Kosovë. Ata nuk e respektojnë as dëshmorin e as qytetarin e Kosovës, prandaj nuk mund ta përfaqësojnë Kosovën. I përjetshëm qoftë kuj-

timi dhe lavdia e dëshmorit, policit të Republikës së Kosovës, Enver Zymberit!", ka shkruar Kurti. Enver Zymberi ndërroi jetë më 26 korrik 2011 pas plagëve të marra nga sulmi i turmave të dhunshme që tentuan ta bllokonin vënien e ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë në pikat kufitare në veri të Kosovës.

Kuvendi nuk arrin t'i votojë dy marrëveshje të rëndësishme ndërkombëtare

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 26 KORRIK - Me 65 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, në mungesë kuorumi, nuk ka kaluar në seancën e së enjtes të Kuvendit të Kosovës Projektligji nr. 06/L-090 për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2017, pjesa e parë, ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Po në këtë seancë nuk ka kaluar as Projektligji nr. 06/L-094 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në programin "Evropa për qytetarët". Votimit i ka paraprirë kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, me paralajmërimin se do të tentojnë dy herë dhe nëse në asnjërën herë nuk arrihen votat e nevojshme, atëherë të dyja projektligjet do të shtyhen për seancën e ardhshme. "Projektligjet do t'i vë në votim vetëm dy herë dhe nëse ato nuk votohen, do t'i dërgojmë në seancën e ardhshme", ka thënë Veseli dhe kështu edhe ndodhi. Për moskalimin e Projektligjit për

Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2017 dhe Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në programin "Evropa për qytetarët" u bë shkak grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) pasi nuk siguroi votat e mjaftueshme, mbi 80 sosh. Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Avdull Hoti, ka thënë se ky subjekt politik nuk voton për shkak të sjelljeve të kryeparlamentarit Kadri Veseli ndaj opozitës. Kurse shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se kjo është e pakuptueshme nga ana e LDK-së kur njëherë ishte pro votimit të këtyre projektligjeve që kanë të bëjnë me BE-në. Krasniqi ka thënë se nuk do të duhej që LDK-ja për një qëndrim të kryeparlamentarit apo të një deputeti të ndryshojë qëndrim. Para se t'i hidhnin në votim këto dy projektligje, ministrja e Integritetit Evropian, Dhurata Hoxha, ka kërkuar unitet për miratimin e tyre. Ajo ka shtuar se Projektligji për Marrëveshjen Financiare rregullon zbatimin e programit IPA 2017, pjesa e parë, duke përf-



shirë 11 projekte të cilët do të ndihmojnë përafrimin me legjislacionin e BE-së, të drejtat e njeriut, eficiencën e energjisë, ekonominë digjitale, sigurinë ushqimore si dhe përkrahjen për lidhjen më të mirë të arsimit me tregun e punës dhe politikat sociale. "Në tërësi, programi konsiston në financimin e 48 milionë

eurove nga ana e Bashkimit Evropian për Kosovën, ndërsa shuma totale është 49.45 milionë euro, ku përfshihet edhe bashkë-financimi nga ana jonë në shumën prej 1.45 milion eurosh. Programi Evropa për qytetarët përmban 187 milionë euro fonde që promovojnë qytetarinë aktive evropiane dhe si fokus ka

autoritetet lokale, organizatat hulumtuese të politikave, grupet e qytetarëve dhe organizatat e shoqërisë civile. Programi zbatohet nëpërmjet thirrjeve për propozime, ku ftohen organizatat nga vendet e BE-së dhe vendet e tjera që kanë qasje në program për të aplikuar", ka deklaruar ministrja Hoxha.

Reshitaj: Prioritet i MMPH-së do të jetë rregullimi i shtretërve të lumenjve

PRISHTINË, 26 KORRIK (ER) - Ministri e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, së bashku me kryetarin e Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, të enjten kanë përfunduar fillimin e punimeve të projektit "Rregullimi i shtratit të Lumit Krena", projekt ky i cili financohet nga MMPH-ja dhe ka vlerën financiare afër gjysmë milion euro.

Me këtë rast ministria Reshitaj ka thënë se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka prioritet rregullimin dhe përmirësimin e gjendjes së lumenjve në tërësi komunat e Republikës së Kosovës. "Rregullimi i shtretërve të lumenjve në gjithë Republikën e Kosovës është një domosdoshmëri. Si ministri e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me

përkushtim të madh jemi duke punuar për fillimin e realizimit të projekteve për rregullimin e shtretërve të lumenjve në gjithë Republikën e Kosovës", ka thënë Reshitaj.

Ajo ka thënë se rregullimi i shtratit të lumit Krena do të jetë në dobi të banorëve dhe të komunës si dhe do ta ruajë florën dhe faunën si pasuri e çmuar natyrore. "Ky projekt do të mundësojë edhe evitim të rrezikut nga vërshimet e mundshme dhe do ta krijojë mundësinë e zhvillimit të qëndrueshëm duke balancuar aspektin ekonomik, social dhe mjedisor", është shprehur Reshitaj.

Para të pranishmëve, Reshitaj ka vlerësuar se përmes projektit të rregullimit të shtratit të lumit Krena, Komuna e Gjakovës do të përfitojë një shëtitore, që do të jetë një korridor ku do të



shërbejë për lëvizje të lirë për qytetarët dhe banorët e kësaj ane. Reshitaj ka shtuar se MMPH-ja, përveç lumenjve, ka prioritet edhe shtrirjen dhe instalimin e ujësjellësit në fsha-

trat e Komunës së Gjakovës. "Në vazhdim të angazhimeve tona nëpër komuna, si ministri e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor jemi duke mbështetur dhe financuar edhe

Projektin për Përfundimin e Punimeve të Ujësllësit për 28 fshatra në Gjakovë, projekt ky që do ta përmirësojë cilësinë e jetës së qytetarëve të Gjakovës", është shprehur shpreh Reshitaj.

Beqaj: Digjitalizimi ndihmon prodhuesit vendorë

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 26 KORRIK - Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, ka takuar të enjten Klubin e Prodhuesve të Kosovës, me të cilin ka bashkëpunuar për mundësitë e bashkëpunimit në shërbim të përmirësimit të bilancit tregtar të Kosovës. Gjithashtu, temë diskutimi ishte edhe përkrahja e ndërmarrësve kosovarë nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë përmes programit për financim të NVM-ve, i lansuar ditë më parë.

Ministri Beqaj ka thënë me këtë rast se Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë do të jetë përkrahëse e fuqishme e prodhuesve vendorë, duke ndihmuar që prodhuesit t'i avancojnë proceset e prodhimit përmes digi-



talizimit. "Prodhuesit vendorë janë punëdhënë, janë tak-sapagues të mëdhenj që po ten-

tojnë ta përmirësojnë bilancin tregtar të Republikës së Kosovës. Diskutoam për përkrahjen

ligjore, institucionale dhe, pse jo, edhe financiare të ideve të tyre që krijojnë vende pune stabile, që

rrisin potencialin ekonomik, me synim që produktet tona ta rrisin nivelin e konsumimit brenda vendit dhe të eksportohen jashtë", ka thënë ministri Beqaj. Ndërsa drejtori i Klubit të Prodhuesve të Kosovës, Astrit Panxha, ka falënderuar ministrin Beqaj për takimin, duke theksuar se ky takim ishte informues në lidhje me projektet e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, si dhe diskutim për mundësitë e bashkëpunimit. "Nga ministri Beqaj u informuan në lidhje me projektet e Ministrisë dhe punët e mira që janë duke u bërë nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, si për projektet inovative që po zhvillohen nga organizatat joqeveritare, por edhe për thirrjet publike për financim të start-upëve dhe NVM-ve", ka deklaruar Panxha.

Gashi: Dënimi ndaj 'Famipës' nuk ka karakter politik

PRISHTINË, 26 KORRIK (ER) - Bordi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) ka mbajtur të enjten një konferencë për medie për të sqaruar në lidhje me dënimin që ka marrë pronari i "Famipës", Ramiz Kelmendi.

Kryetari i Bordit të AKP-së, Petrit Gashi, ka thënë se si bord janë të shqetësuar shumë për sulme individuale ndaj stafit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Ai ka theksuar se në rastin e "Famipa"-s, AKP-ja ka vepruar në mënyrë ligjore. "Sulme personale ka pasur shumë. Vendimet janë të bordit dhe nuk janë vendime të menaxhmentit. Këto vendime janë të bazuara mbi fakte dhe monitorime. Rasti në fjalë është

në agjendën e bordit dhe ju siguroj se për vendimin është marrë parasysh çdo fakt dhe analizë. Rrugëdalje tjetër nuk ka pasur për neve", ka deklaruar Gashi. Ai ka pranuar se ka pasur një vonesë të marrjes së vendimit për lirim të ndërmarrjes nga obligimet. "Ky vendim nuk ka karakter politik", ka thënë Gashi.

Kurse drejtori i AKP-së, Ekrem Hajdari, ka thënë se ndaj Ramiz Kelmendit do t'i ndjekin procedurat ligjore. Deputeti i LDK-së, Ramiz Kelmendi, që është dënuar nga AKP-ja me një milion euro, ka thënë se dënimi ndaj tij është bërë nga drejtori Hajdari, duke e konsideruar atë politik.



Samir Mane: Ferronikeli, potencial i madh i zhvillimit

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 26 KORRIK - "NewCo Ferronikeli Complex LLC", një nga operatorët më të mëdhenj në fushën minerare dhe metalurgjike në Ballkan, është blerë nga një kompani me seli në Mbretërinë e Bashkuar që kontrollohet nga "Balfin Group".

"NKL Limited", shumica e aksioneve të cilat janë në pronësi të "Balfin Group", është një kompani e specializuar në fushën minerare dhe metalurgjike, me seli në Mbretërinë e Bashkuar. Kështu është bërë me dije të enjten me anë të një komunikate për medie të "NewCo Ferronikeli Complex LLC". "NKL Limited ka marrë kontrollin e 'NewCo Ferronikelit' pas ekzekutimit të marrëveshjeve të detyrueshme dhe së bashku me menaxhmentin e kompanisë është duke u përkujdesur për të gjitha përgjegjësitë në baza ditore. 'Balfin', menjëherë pas marrjes së kontrollit, ka treguar angazhimin e tij ndaj 'NewCo Ferronikelit', duke investuar fonde të mjaftueshme për ta rifilluar prodhimin sa më shpejt që të jetë e mundur. 'Balfin' gjithashtu është duke bashkëpunuar me kontraktorët e kompanisë, furnizuesit dhe part-



nerët e saj për të rënë dakord për bashkëpunimin dhe angazhimin e mëtutjeshëm për biznesin dhe operimin e NewCo Ferronikelit", është thënë në komunikatën për medie, duke shtuar se menaxhmenti i kompanisë është mirënjohës për mbështetjen e plotë që është duke pranuar nga aksionarët e saj të rinj dhe së bashku me "Balfin" dhe "NKL Limited" dëshirojnë ta shprehin vlerësimin e tyre për punonjësit, partnerët, institu-

cionin bankar, kontraktuesit, furnizuesit dhe të gjithë komunitetin e Republikës së Kosovës. "Balfin dëshiron të shprehë mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme që Qeveria e Republikës së Kosovës ka dhënë për ekzekutimin e blerjes dhe mirëpret investimet tona të fundit në vend. 'NewCo Ferronikeli' është një aset strategjik i rëndësishëm për Republikën e Kosovës me rëndësi të madhe për ekonominë në përgjithësi. NKL

dhe menaxhmenti tani po ecin përpara me shpejtësi për rifillimin e prodhimit në fabrikë dhe janë duke vepruar fuqishëm në drejtimin për të rikthyer NewCo Ferronikelin si një prodhues dhe eksportues kryesor të Ferronikelit në nivel global", është thënë tutje në komunikatë.

Aksionari kryesor i "NKL Limited", Samir Mane, ka thënë se ka shpresa të mëdha për "NewCo Ferronikeli"-n, duke besuar se

është një investim kyç në Kosovë që ka potencial të jashtëzakonshëm. "Ne dëshirojmë t'i falënderojmë të gjithë personat e përfshirë në bërjen e kësaj të mundshme dhe presim me kënaqësi të punojmë me një ekip të mrekullueshëm në udhëheqjen e këtij biznesi. Ne synojmë që gradualisht ta zgjerojmë kapacitetin prodhues, të investojmë në zhvillimin e teknologjisë dhe të vazhdojmë ta rrisim kompaninë dhe biznesin e saj në baza të qëndrueshme", ka thënë Mane.

"NewCo Ferronikeli" është një nga kompanitë më të mëdha minerare dhe metalurgjike në Ballkan në fushën minerare si dhe eksplorimin e xehes të nikelit dhe në përpunimin e saj për të prodhuar ferronikel që destinohet për eksport në tregjet ndërkombëtare. Kompania operon me një shkritore moderne, zotëron asete minerare për nevojat e saj të prodhimit dhe drejtohet nga një ekip i udhëheqësve dhe ekspertëve në fushën e metaleve dhe minierave. Kurse "Balfin" është një nga kompanitë më të mëdha private në Evropën Juglindore me investime dhe operime të rëndësishme në pasuri të paluajtshme rezidenciale dhe komerciale, shitblerje, miniera dhe shkritore.



Ministri Lluka u bënë thirrje bizneseve polake t'i kthejnë sytë kah Kosova

VARSHAVË, 26 KORRIK (ER) - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, po qëndron në Varshavë, i ftuar nga ministrja e Sipërmarrjes dhe Teknologjisë, Jadviga Emilewitz. Me këtë rast ministri Lluka i ka bërë thirrje biznesit polak t'i kthejë sytë kah Kosova. "Polonia, ndërmarrësia polake, është e interesuar për Ballkanin, në veçanti për

Kosovën. Ne marrim kryesimin e radhës së Bashkimit Evropian dhe Ballkani është një nga prioritetet tona", ka thënë ministrja e sipërmarrjes dhe teknologjisë së Republikës së Polonisë, Jadviga Emilewitz, ministrit të zhvillimit ekonomik të Kosovës, Valdrin Lluka, gjatë vizitës së tij në kryeqytetin polak. Kjo është vizita e parë zyrtare e

një ministri nga Kosova në njërin nga shtetet më të mëdha të Bashkimit Evropian. Ministri Lluka e ka njohur anëtarën e qeverisë polake, që shoqërohej nga një grup drejtuesish agjencish shtetërore të nxitjes dhe garantimit të investimeve, si dhe të disa bankave, me zhvillimet në ekonominë kosovare dhe përparësitë që ua ofron vendi investitorëve të huaj.



Haradinaj në Ferizaj: Duhet të jemi vetvetja edhe në ekonomi

FERIZAJ, 26 KORRIK (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, mori pjesë të enjten në hapjen e panairit të prodhimeve vendore ushqimore, të organizuar nga Market Plus Center, Ferizaj. Kryeministri Haradinaj, duke shprehur respekt për punën që po bëhet në Komunën e Ferizajt, ka thënë se "shumë gjatë e kemi ngrënë produktin e të tjerëve, qoftë politik, qoftë atë të sigurisë, qoftë ekonomik dhe shumë rrallë e shkurt na ka rënë hise me qenë vetvetja, me ngrënë vetë produktin tonë". "Ju po jepni një shembull se, kur nisesh nga vetja, është e mundur dhe ju përgëzoj për këtë porosi që u jepni prodhuesve, konsumatorëve, poli-

tikanëve, vendimmarrësve dhe gjithë të tjerëve", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se duke mos qenë vetja në administrim, qeverisje dhe vendimmarrje, do të jemi të sfiduar. Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka pohuar se u është dhënë dhe do t'u jepet në vazhdimësi përkrahje bizneseve vendore dhe në këtë mënyrë do të ketë një ekonomi më ndryshe, një qytetar me shëndet ndryshe dhe se përkrahja e prodhimeve vendore është siguria e shëndetit të qytetarëve. Pronari i "Market Plus Center", Sylejman Neziri, ka thënë se me promovimin e produkteve vendore e ruajmë traditën e sofrës shqiptare.



'EC': Të parandalohet rrënimimi i ndërtesës në rrugën 'Bajakli' në Prizren

PRIZREN, 26 KORRIK (ER) - "EC Ma Ndryshe" përmes një njoftimi për media ka bërë me dije se kulmi i ndërtesës që gjendet në rrugën "Bajrakli" ka filluar të shembet. "Kjo ndërtesë gjendet në Qendrën Historike të Prizrenit që, sipas Ligjit Nr. 04/L-066 (2012), trajtohet si pronë e trashëgimisë kulturore dhe historike në mbrojtje të

përhershme dhe të klasifikuar si zonë e veçantë e mbrojtur me vlera të interesit lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar. Kjo ndërtesë e banimit ka vlera të trashëgimisë kulturore dhe paraqet një nga tipat karakteristike të arkitekturës së banimit të qytetit. Ndërtesa në fjalë strukturalisht është në gjendje mesatarisht të dëmtuar dhe rrënimimi i kulmit mund të ketë

pasoja të pakthyeshme për ndërtesën", është thënë në njoftimin e "EC Ma Ndryshe". "EC Ma Ndryshe" konsideron se duhet reagim urgjent nga Inspektorati i Komunës së Prizrenit dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në mënyrë që të parandalohet një rrënim i mundshëm dhe të ndërmerren masa preventive për sanimin e gjendjes.

Gjësendet e Jusuf Gërvallës kthehen në vendlindjen e tij

PRISHTINË, 26 KORRIK (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, i ka dorëzuar tetë gjësendet e Jusuf Gërvallës, bashkëshortes së tij, Suzana Gërvalla. Bazuar në marrëveshjen ndërmjet MKRS-së dhe Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë, është realizuar kthimi i tetë gjësendeve të Jusuf Gërvallës, të cilat për një kohë të gjatë kanë qenë nën kujdesin e Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë. Gjësendet të cilat janë kthyer janë: pantallonat, xhakavento, këmisha, fanella, këpucët, pasteli i kuq, librezja dhe çakmaku i Jusuf Gërvallës. Ministri Gashi i ka vlerësuar këto gjësende me vlera të rëndësishme historike dhe kulturore, të cilat nga sot do të jenë të ekspozuara në kullën muze të Jusuf Gërvallës, në Dubovik të Deçanit. Po ashtu, Gashi ka thënë se do të ofrojnë mundësi të tjera për ekspozimin dhe kujdesin ndaj tyre. "Në të njëjtën kohë më



lejoni ta falënderoj Ministrinë e Kulturës dhe Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë për bashkëpunimin e shkëlqyer ndërmjet institucioneve respektive, me theks të veçantë në pasurimin e fondeve muzeale për ekspozim të përkohshëm dhe të përhershëm", është shprehur

ministri Gashi. Ndërkaq Suzana Gërvalla ka falënderuar ministrin Gashi pasi ka pranuar gjësendet e Jusuf Gërvallës dhe është shprehur se ndihet e emocionuar, njëkohësisht e lumtur që, më në fund, gjësendet e bashkëshortit të saj do të qëndrojnë aty ku edhe e kanë vendin.

Komuna e Skenderajt dëgjon kërkesat e qytetarëve

SKENDERAJ, 26 KORRIK (ER) - Në kuadër të përgatitjeve për hartimin e listës së projekteve kapitale, për periudhën trevjeçare, Komuna e Skenderajt, përkatësisht Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, është duke i mbajtur dëgjimet buxhetore nëpër bashkësi lokale të kësaj komune. Në këto takime po marr pjesë edhe kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me drejtorët e drejtorive komunale, i cili po i dëgjon nga afër të gjitha shqetësimet dhe kërkesat e qytetarëve për investime në zonat e tyre të banimit. Nga ana tjetër, meqenëse ky cikël i dëgjimeve është i konceptuar për t'i dëgjuar problemet e qytetarëve sa iu përket shërbimeve që ofrojnë autoritetet lokale të Skenderajt, kërkesat e tyre kanë të bëjnë kryesisht me investime në infrastrukturën rrugore, përkatësisht asfaltim të rrugëve brenda fshatrave, sistemin e kanalizimit, ujësjellësit dhe projekte të tjera. Kryetari

i Komunës, Bekim Jashari, në të gjitha këto takime është duke folur për rëndësinë e pjesëmarrjes së qytetarëve në dëgjimet buxhetore, pasi vetëm ata mund t'i identifikojnë problemet me të cilat ballafaqohen, ndërsa autoritetet komunale pastaj marrin masat e nevojshme për intervenime me anë të projekteve konkrete. Komuna e Skenderajt po vazhdon angazhimin për ta përmbyllur këtë proces të dëgjimeve buxhetore dhe, krejt në fund të tij, kryetari Jashari së bashku me drejtorët komunalë do ta përpilojnë listën e prioriteteve, për të pasuar me fazën e financimit të projektet sipas rëndësisë, gjatë periudhës trevjeçare (2019-2021).



Gjenocidi i pandëshkuar i Serbisë kundër shqiptarëve gjatë luftës në Kosovë nuk ishte as i pari as i rastit

- Fjalë e autores në promovimin e librit "KUNDËR HARRESËS - GJENOCIDI I SERBISË NË KOSOVË 1998-1999", (shqip-anglisht), organizuar nga Shoqata e Historianëve Shqiptarë në Maqedoni në bashkëpunim me Komunën e Çairit në Shkup

Fetnete RAMOSAJ

Të nderuar të pranishëm,
Më lejoni t'u falënderoj të gjithë që na keni nderuar me pjesëmarrjen tuaj në këtë promovim libri.

E falënderoj Shoqatën e Historianëve Shqiptarë në Maqedoni, kryetarin prof. dr. Skënder Asani, kryetarin e komunës së Çairit, prof. dr. Visar Ganiu, kolegun Besnik Rameti dhe të gjithë të tjerët që mundësuan që sot të jemi së bashku, pikërisht në Shkup, në njërën ndër kryeqendrat më të rëndësishme historike e kombëtare të mbarë kombit shqiptar.

Kjo monografi të cilën e promovojmë sot është një monografi e atyre qindra mijëra njerëzve tanë të sakrificave të paçmueshme, të pasqyruar në këtë monografi, por edhe të gjithë të tjerëve që e kishin fatin e njëjtë tragjik me ta.

Sado që dëshmitë faktike të përfshira në këtë monografi i kanë përmasat e historive të tmerrit e të barbarisë çnjerëzore, të aparteidit e të gjenocidit të pandëshkuar të Serbisë, saqë mendja e shëndoshë njerëzore nuk mund ta paramendojë se këtë mund t'ia ketë bërë njeriu-njeriut, megjithatë lirisht mund të themi se këto janë vetëm një pjesë e vogël e gjithë atyre akteve të tmerrshme të gjenocidit, të cilat Serbia okupuese i ka kryer ndaj popullsisë shqiptare pa dallim moshe e gjinie, në gjithë hapësirën etnike shqiptare, për më shumë se një shekull e gjysmë gjatë përpjekjeve të vazhdueshme për okupimin e trojeve etnike shqiptare.

Shumica e materialeve të përfshira në monografi i takojnë periudhës së luftës së fundit në Kosovë 1998-1999, por janë përfshirë edhe materiale të periudhave të mëhershme, duke filluar që nga spastrimi etnik nga popullsia shqiptare i Sanxhakut të Nishit në vitet 1876-1912, kur Serbia arriti t'i spastrojë etnikisht nga popullsia shqiptare mbi 714 fshatra shqiptare dhe më pas t'i serbizojë në tërësi; po ashtu edhe në periudhën e viteve 1912-1913 e në vitet që pasuan u kryen akte të tmerrshme të gjenocidit kundër shqiptarëve, kur vise të tëra shqiptare, qytete e fshatra që nga Shkupi, Kumanova, Dibra, Presheva, Prishtina, Peja, Gjakova, Kaçaniku e shumë e shumë të tjera u bënë rrafsh me tokë dhe u lanë me gjakun e popullsisë shqiptare. Këto akte të mëhershme gjenocidale janë përfshirë për të treguar analogjinë e krimeve serbe, për të dëshmuar me argumente se aparteidi dhe gjenocidi që e kreu Serbia ndaj popullit shqiptar në

fundshekullin XX, nuk ishte as i pari dhe as i rastit, por ishte përsëritur sa e sa herë që nga përpjekjet e para të pushtimit, gjithnjë duke i përsosur mjetet dhe veprimet e krimeve, gjithnjë duke u bazuar në platformat serbomëdha për shfarosjen e shqiptarëve, nëpërmjet ployave e masakrave makabre, që kishin filluar që nga përpjekjet për ngritjen e shtetit të Serbisë, në fillim të shek. XIX. Në këtë drejtim, programin sekret për krijimin e Serbisë së Madhe "Naçertanije", të cilin ministri i brendshëm i Serbisë, Ilija Garashanin, e institucionalizoi si platformë politike dhe juridike shtetërore, që nga viti 1844, vazhdon të shërbejë si bazë e të gjitha planprogrameve shtetërore serbomëdha.

Është e tmerrshme analogjia e krimeve të përsëritura sa e sa herë, qoftë në shekullin XIX, qoftë në fillim të shekullit XX, në mes shekull e në fundshekullin XX. Për shembull, po të kemi parasysh dëshmitë se si është kryer ploya në krahinën e Rugovës, në Shtupeq të Madh, në dimrin e vitit 1919, kur janë therur në bajoneta e janë djegur në zjarrin e kullave të mbushura me sanë qindra civilë shqiptarë, madje edhe gra shtatzëna, foshnje e fëmijë të vegjël, shohim se të njëjtat akte të gjenocidit i kanë përsëritur edhe gjatë luftës më 1998-1999 në shumë vise të Kosovës, duke i mbyllur nëpër shtëpi e duke i djegur në krematoriume. Përmendim këtu, vetëm rastin e Paklekut të Vjetër, komuna e Drenasit, ku në shtëpinë e Sinan Muqollit, forcat serbe i mbyllën në shtëpi 56 civilë shqiptarë, të cilët i vranë e disa prej tyre i dogjën për së gjalli pasi i lye me benzinë: 36 prej tyre ishin femra; 26 ishin foshnja e fëmijë, më i vogli 2-muajsh.

Është me rëndësi të theksohet se format dhe metodat e kryerjes së krimeve akteve të gjenocidit nga forcat pushtuese të Serbisë anekënd Kosovës kanë qenë pothuajse identike, kanë qenë të ndryshme vetëm viktimat e shumta.

Pra, kjo e dëshmon se çdo gjë është zbatuar nëpërmjet planeve dhe direktivave shtetërore të Serbisë. Tashmë është e vërtetuar nga dëshmi të shumta, disa prej tyre të botuara edhe në këtë monografi, se forcat serbe herë pas here gjatë operacioneve të tyre gjenocidale i kanë veshur uniforma të kamufluara, duke i përdorur emblemat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) gjatë operacioneve për vrasjet e spastrimin etnik ndaj popullsisë shqiptare, por edhe të tjerëve. Kampi i përqendrimit në Burgun e Dubravës, komuna e Istogut, është ndër aktet më të tmerrshme të



gjenocidit që janë kryer gjatë luftës në Kosovë. Në fund të muajit prill të vitit 1999, shumicën e të burgosurve shqiptarë i mblodhën nga të gjitha burgjet e Serbisë dhe i kthyen në objektet e Burgut të Dubravës, i cili që nga vera e vitit 1998 e deri atëherë kishte shërbyer si bazë e përqendrimit të njërive speciale të Serbisë, JSO, PJP etj. Prandaj, Serbia duke pasur informacione të sakta se ky burg ishte i komprometuar si vendqëndrim i forcave serbe ishte cak i sulmeve ajrore të NATO-s, Serbia i tërhoqi njësitet speciale të policisë e të ushtrisë serbe dhe në vend të tyre i burgosi rreth 1000 të burgosur politikë shqiptarë dhe pengje të luftës, por kishte edhe të burgosur shqiptarë që uvanin dënimin për krime ordinare. Të gjithë duarlidhur iu nënshtuan kasaphanës nga forcat serbe.

Është e rëndësishme të theksohet se sipas dëshmive të shumta, pothuajse në të gjitha rastet ku forcat serbe kanë kryer vrasje në masë, i kanë fotografuar dhe regjistruar në videokamera trupat e shqiptarëve të vrarë e të masakruar. Fotografi e videoregjistrime të tilla forcat serbe kishin bërë edhe gjatë masakrës në Burgun e Dubravës. Po ashtu fotografi e videoregjistrime kishin bërë edhe në rastin e masakrës së Krushës së Vogël të Prizrenit. Por veprime të tilla kanë kryer edhe në shumë raste të tjera anekënd Kosovës. Shtrohet pyetja: Ku janë këto fotografi, ku janë këto videoximire?! Ka dëshmi se trupat e shqiptarëve të vrarë e të masakruar, Serbiapo i paraqet në arenën ndërkombëtare si viktimat serbe, të vrarë nga shqiptarët-UÇK-ja apo nga NATO-ja. Siç është publikuar në mediet serbe dhe në ato ruse, është parë se fotografi të tilla janë përdorur në protestat e organizuara kundër Kosovës në Beograd e në Moskë, ku në disa raste konkretisht janë përdorur fotografi të viktimave shqiptare nga komuna e Gjakovës, të cilat i kanë paraqitur si viktimat serbe.

Përveç plaçkitjes dhe shkatërrimit të pasurisë së shqiptarëve, shkatërrimit të qyteteve e fshatrave shqiptare, plaçkitjes dhe shkatërrimit të trashëgimisë kulturore e të dokumentacioneve administrative, u vranë e u masakruan mbi 12 mijë civilë shqiptarë, ende konsiderohen të zhdukur mbi 1660 persona, mbi një milion shqiptarë, të ballafaquar me vdekjen, u dëbuan jashtë Kosovës gjatë operacionit për spastrimin etnik, u përdhunuan rreth 20 mijë femra e meshkuj

shqiptarë, madje edhe fëmijë 7-vjeçar; qindra fëmijë, madje edhe foshnja u vranë në barkun e nënave shqiptare me pretekstin se po i ekzekutonin "armiqtë e ardhshëm të Serbisë".

Serbia ka shkuar aq larg sa që t'i vrasë vet edhe fëmijët serbë për t'i fajësuar shqiptarët. Përmendim këtu krimin monstruoz të kryer në kafenenë "Panda" në Pejë, më 14 dhjetor të vitit 1998, ku gjashtë të rinj serbë u vranë nga njësi special i JSO-së, që ishte nën komandën e Sigurimit Shtetëror të Serbisë, dhe për këtë e fajësuan UÇK-në, i fajësuan shqiptarët!

Ndonëse aktin terrorist të vrasjes së të rinjve serbë në kafenenë "Panda" në Pejë, Serbia ua vuri në barrë shqiptarëve, përkatësisht Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për çka keqtrajtoi e burgosi qindra shqiptarë në Pejë, vetëm në vitin 2013 ajo zyrtarisht e pranoi krimin, por nuk ndërmori asnjë veprim për t'i dhënë epilog këtij krimi.

Paraprakisht, sipas dëshmive nga zyrtarë të lartë të ish-Qeverisë Jugosllave gjatë luftës, në nëntor të vitit 1998, Millosheviqi dhe "Shtabi Strategjik" i tij, kishte marrë vendimin për kryerjen e një serie të krimeve kundër serbëve dhe shqiptarëve të ekspozuar si mbështetës të Serbisë, për ta akuzuar UÇK-në.

Përveç këtyre, Serbia i ka fshehur humbjet e saj frontale gjatë gjithë luftës në Kosovë. Familjarëve të të vrarëve në Serbi nuk ua ka treguar të vërtetën për humbjet që i kanë pësuar në luftime me UÇK-në, prandaj tash këta të vrarë tenton t'i përdorë për qëllime dhe akuza të tjera për periudhën e pasluftës.

Përderisa, gjatë vitit 1998, forcat pushtuese serbe trupat e shqiptarëve, pasi i vrisnin e i masakronin, i digjin nëpër shtëpitë e oborret e tyre, në furrat e termocentraleve në Obiliq, në furrat e Ferronikelit e të shkretoreve në Minierën e Trepçës, i hodhën në puse (bunare) të ujit të pijshëm e në gropa të gëlqeres, i varrosën në varreza masive e i zhvarrosën për t'i zhdukur pa gjurmë, apo për ta fajësuar UÇK-në kinse për vrasjen e tyre, gjatë vitit 1999, një pjesë të madhe të kufo-mave të civilëve shqiptarë (fëmijë, gra e pleq), të vrarë e të masakruar nga forcat okupuese serbe, i transportuan me kamionë frigoriferi për në Serbi, duke i varrosur në varreza sekrete masive në poligonet e policisë e të ushtrisë serbe-jugosllave për t'i zhdukur dhe shkatërruar

provat e gjenocidit të Serbisë ndaj shqiptarëve. E tërë kjo u bë në kuadër të operacionit sekret "Spastrimi" ("iš?enje"), për të cilin Millosheviqi dhe "Shtabi Strategjik" i tij kishte marrë vendim që në mars të vitit 1999. Në këtë operacion për zhdukjen e gjurmëve të krimeve kanë marrë pjesë strukturat më të larta shtetërore të Serbisë dhe të ish-mbetjes jugosllave (RFJ).

Deri më tani, në këto varreza sekrete masive në Serbi, janë gjetur trupat dhe mbetjet mortore të mbi 1000 civilëve shqiptarë nga anë të ndryshme të Kosovës, disa prej të cilëve i kishin zhvarrosur nga Kosova për në Serbi, por kishte edhe trupa të shqiptarëve të vrarë, që këto varreza sekrete masive i kishin varreza të para.

Sipas antropologëve ndërkombëtarë, të cilët i kanë mbikëqyrur zhvarrimet në Serbi, vetëm në varrezat sekrete masive në poligonet e Kazermës "13 Maji" në Batajnicë, të paktën trupat e 82 civilëve shqiptarë, kryesisht fëmijë e të rinj, para se të përfundonin në atë varrezë sekrete masive ishin trajtuar në spitale, duke e ngritur dyshimin e bazuar se atyre paraprakisht u janë marrë organet. Viktima më e fundit e identifikuar nga të kthyerit nga varrezat sekrete masive të gjetura në Serbi, është foshnja 6-muajshe, Dafina Qelaj (e ekzekutuar në krahatorin e nënës së saj, gjatë masakrës që e kryen forcat serbe në Izbicë (Skenderaj)), në mars të vitit 1999 .U varros më 28 dhjetor 2017, në varrezat e dëshmorëve dhe martirëve në Izbicë. Ajou vra nga forcat ushtarake serbe të komanduara nga gjenerali serb Lubisha Dikoviç, aktualisht Shef i Shtatmadhorisë së Ushtrisë së Serbisë.

Dihet se krimet e luftës nuk vjetrohen. Populli shqiptar qoftë në Kosovë, qoftë në Maqedoni, qoftë në Kosovën Lindore, qoftë në Mal të Zi, në Shqipëri etj., i ka pasur të njëjtat përvoja të hidhura, të njëjtat pësime. Prandaj, është e udhës që të bashkërendojmë punën dhe veprimtarinë për të zbardhur të vërtetën për krimet e luftës dhe gjenocidin serb kundër shqiptarëve, jo vetëm për luftën e fundit, por për gjithë gjenocidin e kryer gjatë njëqind e pesëdhjetë viteve të kaluara, për të kërkuar drejtësi për të rënë, për ta luftuar harresën, sepse përjetimet kanë qenë të tmerrshme dhe është e pafalshme nëse nuk mësojmë nga historia.

Një "etimologji" për vetveten (2)


Nga erdhën shqiptarët në Ballkan sipas autores

Prof. dr. Hysen MATOSHI

Tragjike a qesharake, nuk di njeriu ç'të thotë!? Për të dëshmuar se shqiptarët nuk janë autoktonë, autorja i nxjerr këto toponime me bazë të suedishtes, nga hapësira e së cilës, sipas saj, janë edhe përdoruesit e tyre!? Udhëpërshkruesi francez Ami Bue, i cili kishte kaluar në këtë vend më 1836, e përshkruan Ferizajn e sotëm si një vend kënetash me një han midis tyre. Emërtimi i tij lidhet pikërisht me emrin e pronarit të këtij hani, Feriz Shashivarit. Nuk kishte akullnaja veriore dhe as ishte aty ai farë "Jani" i supozuar nga autorja e nuk kishte as kanxha e khetra si gjurmë të tij. Në të vërtetë, toponimi Tasjan përbën versionin e fjalës latine Station (sta - qëndron; station - stacion), i cili iu dha këtij vendi pas ndërimit të hekurudhës më 1874. Natyrisht në shqipe kjo fjalë hyri nga varianti i turqishtes Istasyon. Station (latinisht, frëngjisht) = Istasyon (turqisht) = Tasjan (trajta e përvetësuar nga popullata shqiptare, e cila deri vonë mund të dëgjohej nga të moshuarit e Ferizajt dhe të Rrafshit të Kosovës). Qartazi këto emërtime nuk përbëjnë fjalë të sjella nga viset veriake nordike dhe pretendimi se ato emërtojnë fakte që lidhen me klimën e kësaj hapësire janë krejt joracionale, të pakapshme për mendjen e çdokujt që e di se ku ndodhet qyteti Ferizaj. Edhe nëse do të ekzistonte Jani i supozuar nga autorja, ai nuk do të kishte nevojë për kurrfarë "kanxhe" për të ecur mbi "akullnajën" e Ferizajt, ngaqë kushtet klimatike nuk lënë dyshime në këtë drejtim. Për hir të së vërtetës duhet thënë se Ferizaj karakterizohet me një temperaturë mesatare rreth -1 gradë të Celsiusit në muajin më të ftohtë të vitit, në janar. Ndonëse absurde, duhet thënë se këto shtresa të akullit në

kokën e autores më parë ia krijon paradoksalisht njëfarë zjarrmie për të dëshmuar se shqiptarët janë ardhacakë veriakë në këto hapësira. Janë të panumërta toponimet e tjera, të cilat Jela Nilovi? - Mitrovi? i interpreton sipas kuteve të saja "shkencore" (më mirë thënë çelësit të saj shkencor) dhe në kundërshtim të plotë me parimet e dijeve themelore etimologjike, por ne, për shkak të kohës, nuk do të ndalemi më gjatë te to. Mjafton të përmendim edhe rastin e toponimit Metohia, të cilin, në kundërshtim me të dhënat e verifikueshme gjuhësore e të njohura gjithandej, sipas të cilave ka kuptimin "prona të kishës", e nxjerr po ashtu si një fjalë suedeze, përkatësisht si togfjalësh "mått och hy", që, sipas saj, ka domethënien "lëkurë e përpunuar në të cilën dikur është shkruar"! Interpretime "interesante" me shtresime gjuhësore suedeze, autorja ofron edhe për toponime të tjera me rëndësi për hapësirën shqiptare, sikundër janë: Shkupi, Shkodra, Deçani, Durrësi, pastaj vetë toponimi Shqipëri etj.

Autorja e këtij libri këmbëngul se shqiptarët, në kohët e hershme, jetonin në veriun e skajshëm nordik. Historikisht ata kishin lëvizur drejt jugut, kuptohet të dëbuar nga popujt suedeze dhe gjermanë, pas luftërave të rrepta që kishin zhvilluar me ta. "Shqipëria ishte krijuar si tokë e zbrazur me qëllim që aty të sillej një numër sa më i madh shqiptarësh, të cilët ishin dëbuar nga vendet suedeze dhe gjermane, nga hapësira e Vendlandit, territor ndërmjet Hanoverit dhe Hamburgut, në të cilin shqiptarët, nën emërtimit vendët, i kishin kaluar 2-3 shekuj, sepse aty ishin dëbuar nga territori i Suedisë. Për ta ndërlidhet edhe fjala vandal (autorja mendon se vendët dhe vandalët ishin i njëjti popull, pavarësisht se nga leksikonët



suedeze, të cilëve iu referohet, ky identifikim përjashtohet, vër. H. M.), sepse nuk kishin dashur që ta pranonin krishterimin dhe për faktin se i kishin rrënuar kishat. Fjala vandal vjen nga: vann dals(land). Dalslandi është një trevë në jugperëndim të Suedisë në të cilën, për herë të fundit, kishin jetuar parashqiptarët..." Pasi e "dëshmon" origjinën e shqiptarëve, autorja e krijon terrenin për të plasuar tezën mbi autoktoninë serbe në Ballkan. Natyrisht së pari e qorton tezën e historiografisë serbe që nuk e artikulonte fuqishëm gjenezën ilire të sllavëve, të publikuar në një enciklopedi të shtëpisë botuese "Prosveta", e cila thoshte se "dikur besohej se sllavët e jugut ishin pasardhës të ilirëve". Duke e qortuar këtë formulim dyshues e mohues lidhur me gjenezën e sllavëve të jugut, ajo konstaton: "Tani kur besojmë në Zotin askush nuk e ka kthyer besimin se sllavët e jugut janë pasardhës të ilirëve. Megjithatë, gjuha e dëshmon këtë si të saktë. Ardhja nga malet e Karpateve u përgjigjej më shumë historianëve për shkakun se kemi dashur që të jemi sa më pranë rusëve, ose për faktin se atyre (historianëve serbë, vër. H. M.) u dukej e pakuptimtë që ne të kishin dy origjina, ndërsa shqiptarët asnjë, ndaj edhe vëllazërisht ua kemi lënë njërën". Sipas saj, fajin e

kishte historiografia serbe që shqiptarëve ua kishte dhuruar origjinën ilire, ndërkohë që intenca e saj "argumentuese" është se shqiptarët janë të ardhur në Ballkan "në hapësirën serbe të dhuruar nga Zoti". Edhe pse citon leksikone suedeze, sipas të cilave populli vendi ishin sllavë të mesjetës, të cilët kishin pasur konflikte të mëdha me skandinavët dhe gjermanët në shek. X dhe XI, kur edhe ishin nënshtruar prej tyre, autorja me zemërgjerësi këtë epitet ua vesh paraardhësve të shqiptarëve. Qëllimi është i qartë: ajo nuk duron dot që shqiptarët të kundrohen si popull autokton, i cili ka një vijimësi në Ballkan që nga lashtësia e deri në ditët e sotme.

Spastrimi etnik i "Kosmetit" - "Testament" i Sami Frashërit

Megjithatë, edhe historia e mëvonshme është objekt interesimi i autores Jela Nilovi? - Mitrovi?. Madje, mund të thuhet se zhvillimet që zënë fill nga gjysma e dytë të shekullit XX janë motivi kryesor i saj për ta shkruar një vepër të tillë. Ajo merret me rrethanat politike dhe veçmas me të ashtuquajturën "shpërngulje të serbëve nga Kosova", të cilën nuk ngurron ta quajë edhe "spastrim etnik të serbëve nga Kosova". Në fakt, krejt bota normale e kishte identifikuar plotësisht të kundërtën, pra spastrimin etnik të Kosovës nga popullsia e saj autoktone shqiptare, së pari si rezultat i shtypjes kombëtare, sociale etj. dhe veçmas si rezultat i dëbimit brutal të shqiptarëve, që ishte ndërmarrë brutalisht nga fillimi i viteve 90 për të kulmuar më 1999, kur u dëbuan gati një milion shqiptarë nga shtëpitë e tyre stërgjyshore. Sipas saj, spastrimi etnik i serbëve nga Kosova ishte pjesë e programit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit: "Spastrimi

etnik i Kosmetit nga serbët është pjesë e planit të quajtur Lidhja e Prizrenit (1878-1881), mbajtur në Prizren, udhëheqës ideor i së cilës ka qenë Sami Frashëri, shqiptari i cili ia ka lënë kombit të tij "Testamentin", që përbëhej nga tri pjesë: çfarë ishte, çfarë është dhe çka do të bëhet. Çfarë ishte? Shqiptarët, përkatësisht ilirët, ishin banorët e hershëm të Ballkanit. Aleksandri i Maqedonisë dhe Aristoteli ishin të tyre, pastaj kishin ardhur sllavët dhe i kishin rrezikuar. Çfarë është? Është se ata i falënderohen shumë Turqisë, por Turqia është në prag të vdekjes. Çka do të bëhet? Detyra e tyre është që në aspektin numerik ta pushtojnë sërish Ballkanin." Kaq shumë të pavërteta në një tekst kaq të shkurtër! Samiu nuk ishte ndër udhëheqësit e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Ky nder, sikundër dihet, i ka takuar vëllait të tij, Abdylit, i cili edhe është dënuar nga Porta e Lartë për këtë veprimtari. Ndërkaq "Testamenti" për të cilin flet autorja (është fjala për traktatin "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe do të bëhet") nuk ka mundur të jetë bazë për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, marrë parasysh faktin se është shkruar dhe botuar plot 21 vjet pas të parës përpjekje të shqiptarëve për të dalë nga konturat e Perandorisë Osmane. Edhe interpretimi i përmbytjes së veprës së Samiut është tendencioz, ngase ky program ka në fokus krijimin e shtetit shqiptar në hapësirat e etnike shqiptare dhe aspak nuk bën fjalë për ndonjë tokë, të cilën do të duhej marrë nga të tjerët. Si e tillë kjo vepër e Samiut u bë manifest i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, e cila në planin kohor nuk shtrihet vetëm në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Në një plan më të gjerë kjo vepër u përjetua si një program kombëtar edhe në periudhat e mëpastajme. (Vijon)

Durim Kryeziu, pjesë e 'Matchmaking Forum' në Festivalin e Filmit të Pulës

PRISHTINË, 26 KORRIK - Regjisori Durim Kryeziu, me filmin i tij "Familja", ishte një nga 14 projektet e zgjedhura për t'u prezantuar përpara producentëve evropianë në Festivalin e Filmit të Pulës në Kroaci. Festivali i Filmit i Pulës për 65 vjet është një nga ngjarjet më të rëndësishme të industrisë së filmit në Evropën Juglindore dhe në Mesdhe. "Matchmaking Forum" është

një program i ri, i cili u mbajt për herë të parë këtë vit. Programi u ofron producentëve mundësinë për t'u takuar me shumë financues të ndryshëm që janë pjesë e industrisë së filmit si: distributorë, agjentë të shitjes, banka, financues private dhe publike, regjionet dhe komisionet të filmit, transmetuesit, platformat e internetit etj. "Pas prezantimit ka pasur interesim të madh për projektin 'Familja',

pastaj janë realizuar shumë takime me producentë, distributorë, fondacione të ndryshme dhe përfaqësues të HBO-së dhe Euroimages. Unë pres që këto takime do të sjellin bashkëpunime të reja në të ardhmen e afërt", u shpreh regjisori Durim Kryeziu. Projekti filmik "Familja" është mbështetur financiarisht nga Qendra Kinematografike e Kosovës si film debutant.



E rrallë

Noton tri orë me duar e këmbë të lidhura

Yane Petkov është një instruktor noti nga Bullgaria që u përpoq vitin e kaluar ta thyente rekordin e peshkatarit Gopak Kharvi, por nuk ia doli. Këtë vit pati sukses pasi notoi për tri orë në Liqenin e Ohrit për rreth 3.380 metra, ndërsa rekordi i indianit që fitoi në 2013 ishte 3.071 metra.



BARSOLETA E DITËS



Ligji i gravitetit

- Babi, ç'është ligji i gravitetit?
- Të them të drejtën, nuk e di. Ku ka kohë babi yt t'i ndjek punimet e kuvendit dhe të mësojë për të gjitha ligjet që miraton?



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit
në ora 16:00

“INCREDIBLES 2” 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

Rolet: Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

Regjia: Brad Bird



Në ora 18:20

“FUTURE WORLD”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

Regjia: James Franco



Në ora 20:00

“ANT-MAN AND THE WASP” 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

Rolet: Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

Regjia: Peyton Reed




Në ora 22:00

“LOVING PABLO” (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

Rolet: Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

Regjia: Fernando León de Aranoa



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

FOTO E DITES



Një protestues mban në duar flamurin e Shoqatës së Taksive gjatë grevës së shoferëve të taksive në Barcelonë. /AFP/

E jashtëzakonshme

Krijohen xhamitë lëvizëse për Lojërat Olimpike 2020

Derisa Japonia po përgatitet të presë vizitorë nga e gjithë bota për Lojërat Olimpike 2020, një kompani sportive në Tokio ka krijuar një xhami me rrota që besimtarët myslimanë të ndihen si në shtëpi.



Në pjesën e pasme të kamionit me peshë prej 25 tonësh ngrihet një portë e lartë për ta shfaqur hyrjen, më pas tërhiqen kapakët anësorë, e cila mund të akomodojë deri në 50 persona.



DASHI

Gjërat që ju nuk i keni pasur problem në marrëdhënien tuaj në çift, sot do t'ju duken tejet të komplikuar. Beqarët do të ndihen mirë me personat që kanë njohur.



DEMI

Ka kohë që dashuria nuk ju ka buzëqeshur. Jeni mësuar me këtë fakt dhe sot do të habiteni nga një propozim i papritur.



BINJAKËT

Familja ka marrë masat që sot gjithë koha e shpenzuar të jetë me të. Do të ndiheni të mbushur shpirtërisht.



GAFORRJA

Plot besim në vetvete nuk do të tërhiqeni në ato raste kur duhet ta merrni iniciativën. Në planin financiar do të dini si t'i menaxhoni të ardhurat.



LUANI

Që në orët e para të ditës sot do të merrni një konfirmim që kishit kohë që e prisnit. Kjo do t'ju sjellë shumë në humor.



IRGJËRËSHA

Sot do t'ju duket se po përballoni shpërthimin e fuqishëm të diçkaje apo dikujt që keni në krahë, por nuk dini si ta shpjegoni.



PESHORJA

Sa më shumë që të jeni teatral në prezantimin tuaj të fakteve, aq më shumë partneri/ja do t'ju besojë dhe do t'ju mbështesë. Në planin financiar merrni masa strikte.



AKREPI

Surprizat gjithmonë ju kanë pëlqyer. Një person afër jush e di këtë gjë dhe sot do t'ju japë një emocion të veçantë.



SHIGJETARI

Nuk ndiheni mirë nga gjendja shpirtërore sot dhe do ta reflektoni këtë gjë dhe në humorin tuaj. Do të keni një zënkë me një familjar.



BRICJAPI

Disa probleme të vogla shëndetësore sot ju kanë shqetësuar disi. Do të këshilloheni me një mjek.



UJORI

Një person ka hyrë përsëri në jetën tuaj nga e kaluara. Ky fakt nuk po ju shqetëson fare, përkundrazi po e shijoni.



PESHQIT

Edhe pse nuk doni, një problem familjar ju shqetëson prej kohësh. Duhet t'i menaxhoni situatat brenda familjes.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

BRAUNSCHWEIG - KARLSRUHE

2

CLERMONT FOOT - CHATEAUROUX

1

STANDARD LIEGE - GENT

3+

FFK-ja bën thirrje të mbushet stadiumi 'Fadil Vokrri'

Hapja e stadiumit në kryeqytet po pritët me interesim të jashtëzakonshëm, pasi tash e tutje do ta bartë emrin e legjendës së futbollit dhe ish-kryetarit të Federatës së Futbollit të Kosovës, Fadil Vokrri, por edhe për faktin se në këtë ndeshje të pranishëm do të jenë inspektorët e FIFA-s për inspektim, prandaj FFK-ja ka bërë thirrje që më 28 korrik të mbushet stadiumi me adhurues të futbollit



PRISHTINË, 26 KORRIK - Krahas punëve në përfundim e sipër, në stadiumin "Fadil Vokrri" po vazhdojnë edhe përgatitjet për ndeshjen testuese të 28 korrikut, e cila do të zhvillohet ndërmjet veteranëve të KF Flamurtarit nga Vlora, veteranëve të FC Prishtina dhe një ekipi i përbërë nga politika dhe estrada. Tashmë dihen pjesëmarrësit nga Shqipëria dhe të Klubit Prishtina sikur edhe njerëzit nga politika dhe disa emra nga estrada. Edhe në opinion po mbretëron një interesim i madh për faktin që tash e dy vjet stadiumi i qytetit ka qenë në rinovim dhe se ky stadium do ta mbajë emrin e legjendës së futbollit dhe ish-presidentit të FFK-së, Fadil Vokrri. Ndeshjet do të zhvillohen prej orës 20:00 nën dritat e reflektorëve që i japin hijeshi shtesë stadiumit buzë Arbërisë. "U bëjmë thirrje të gjithë adhuruesve të jenë në numër sa më të madh, kurse hyrja është falas dhe tash stadiumi ofron komoditet të madh. Po ashtu, numri i madh i shikuesve do të jetë edhe një nga testet që do të ketë ky stadium nga inspektorët e UEFA-s e të cilët do ta japin licencën për t'u zhvilluar ndeshjet kualifikuese për Ligën e Kombeve që fillojnë në shtator", thuhet në njoftimin e FFK-së. Në këtë ndeshje do të luajnë disa nga yjet e futbollit të viteve '80 e '90 nga Shqipëria dhe Kosova.

KF FLAMURTARI

1. Vasil Ruçi
2. Perlat Musta
3. Artur Lekbello
4. Kreshnik Cipi
5. Rrapo Taho
6. Roland Iliadhi
7. Vangjel Laluci
8. Përparim Lushaj
9. Qerem Memushi
10. Dritran Resuli
11. Latif Gjondeda
12. Dritan Sadedini
13. Gert Haxhiu
14. Fjodor Xhafa
15. Saimir Haxhiu
16. Koto Zilja
17. Roland Meli
18. Rexhep Rexhepi
19. Gentian Mezani

FC PRISHTINA

1. Shukri Paqarada
2. Ahmet Beselica
3. Arbnor Morina
4. Nazmi Rama
5. Isa Sadriu
6. Fadil Berisha
7. Eroll Salihu
8. Muharrem Sahiti
9. Besnik Kollari
10. Adil Vokrri
11. Sunaj Keçi
12. Kushtrim Munishi
13. Suad Keçi
14. Bedredin Gjinali
15. Abdyl Bellopoja
16. Arsim Abazi

17. Fatmir Namani
18. Ramiz Krasniqi
19. Afrim Toverlani
20. Gramoz Vokrri

SHTABI TEKNIK

1. Ajet Shosholli
2. Shfeshet Sinani
3. Ramdan Cimili
4. Jusuf Tortoshi

EKIP I POLITIKËS DHE ESTRADËS

POLITIKA

1. Kujtim Gashi (PDK)
2. Bekim Haxhiu (PDK)
3. Armend Zemaj (LDK)
4. Ahmet Isufi (AAK)
5. Rasim Demiri (AAK)
6. Bilall Sherifi (NISMA)
7. Shpend Ahmeti (PSD)
8. Dardan Sejdiu (PSD)
9. Abert Kinolli (PRO+6)

ESTRADA

1. Meda
2. Blero
3. Osman Azemi
4. Ermali
5. DJ PM
6. DJ DAGZ
7. Mensur Safçiu
8. UKI
9. Esheref Durmishi
10. Arnedn Ismajli
11. Vedat Bajrami

SHKURT

Kosova mposhti Bullgarinë

Kombëtarja e Kosovës U20 në hendboll fitoi bindshëm me rezultat të lartë ndaj Bullgarisë 43:23 (20:14). Gjatë ditës para ndeshjes delegacionin e FHK-së e priti në Ambasadën e Republikës së Kosovës, ambasadori Skënder Durmishi, i cili ishte i pranishëm edhe në ballafaqimin me Bullgarinë në Palestrën Sportive "Verde Sport Complex". Pas ndeshjes bashkërisht u festua fitorja e cila iu siguron djetë moshave të Kosovës luftën për vendin e pestë.

Xhudistët fillojnë mbledhjen e pikëve për normën Olimpikë "Tokyo 2020"

Sportistët më të suksesshëm në Kosovë, xhudistët, prej nesër do ta fillojnë misionin e tyre për ta fituar normën Olimpikë, Tokyo 2020. Prej 27-29 korrik 2018 në Zagreb të Kroacisë do të mbahet gara e Grand Prixit, e cila vlen për grumbullimin e pikëve për Lojërat Olimpikë Tokyo 2020. Kosova përfaqësohet me xhudistët Akil Gjakova (-73 kilogramë), Distria Krasniqi (-48 kg) dhe Nora Gjakova (-57 kg). Distria do të debutojë në kategorinë -48 kg, me të cilën synon të garojë në LO Tokyo 2020. Ajo deri më tani garonte në -52 kg. Sot (e premte) garojnë Distria dhe Nora, kurse të shtunën Akili.

Ylli i çiklizmit gabimisht ndalet nga policia

Ylli i çiklizmit Christopher Froome (33) është rrëzuar gjatë etapës së 17 të Tour de France në prag të fundit në "Col du Portet". Ai është ngatërruar nga policia si një tifoz për shkak të xhakëtës së zezë që kishte veshur për shkak të shiut. Gjatë atij incidenti, Froome është rrëzuar nga biçikleta, por nuk është dëmtuar, këtë e ka konfirmuar edhe Team Sky. "Ishte një keqkuptim, Chris është mirë", ka thënë një zëdhënës i ekipit. Froome ka zbritur në vend të tretë pas Bagneres-de-Luchon.

Besnik Hasi në Arabinë Saudite

